



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Procesverbal

Tiranë, më 17.04.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 21 dhe 26 mars 2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i programit të punës të komisionit për datat 15 prill-3 maj 2019.
3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar".
4. Seancë dëgjimore për emërimin në postin e Kreut e Misionit Diplomatik të zotit Gazmend Barbullushi, kandidat për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Marokut, në Republikën Islamike të Mauritanisë si dhe Principatën e Andorrës.

Marrin pjesë: Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Ervin Bushati, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermani, Evis Kushi, Andrea Marto, Reme Lala, Ligoraq Karamelo, Edlira Hyseni

Mungojnë: Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Rudina Hajdari

Të ftuar:

Rovena Voda – Zëvendësministre e Punëve të Brendshme

Emirjola Yzeiraj - Shefe e sektorit të Marrëveshjeve në MPB

Xhevair Karaj – Përfaqësues nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit

Sokol Dedja – Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gazmend Barbullushi – Kandidat për kreun e Misionit Diplomatik, Sekretar i
Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Hapet mbledhja

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 17 prill 2019.

Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 21 dhe 26 mars.

Po ashtu, kemi shqyrtimin dhe miratimin e programit të punës së komisionit për datat 15 prill deri më 3 maj.

Më pas do të diskutojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta të kontrollit kufitar”. Për këtë projektligj kemi të ftuar zonjën Voda, Zëvendësministre e Punëve të Brendshme.

Mirë se vjen, zonja Voda!

Kemi të ftuar zonjën Yzeiraj, shefe e sektorit të Marrëveshjeve dhe zotin Karaj nga drejtoria e Kufirit dhe Emigracionit.

Mirë se vini, zotërinj!

Më pas kemi seancë dëgjimore për emërimin në postin e kreut të Misionit Diplomatik të zotit Barbullushi, kandidat për Ambasador të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Marokut në Republikën Islamike të Mauritanisë dhe në principatën e Andorrës.

Para se të fillojmë me procedimin e rendit të ditës, dua t’u uroj mirëseardhjen dhe punë të mbarë anëtarëve të rinj të Komisionit për Politikën e Jashtme!

Jemi dakord me miratimin e procesverbaleve të dy datave që përmendëm? Nëse po, vazhdojmë.

Jemi dakord për programin e punës së komisionit?

Vazhdojmë me diskutimin e projektligjit.

Ligoraq Karamelo – Përshëndetje, zonja kryetare!

Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Ju falënderoj për fjalët dhe për mirë se ardhjen tuaj këtu!

Dua t’ju shpreh mendimin dhe opinionin tonë, pasi ne do të jemi konstruktivë dhe do të bashkëpunojmë për proceset kryesore, siç janë problemet e integritetit dhe problemet e tjera që kanë të bëjë me reformat e ndërmarra nga qeveria. Në kuadrin e programit të punës së komisionit për punën në vijim, unë gjykoj se është e domosdoshme që në komision të

raportohet nga ministri i Jashtëm, ose më mirë të themi, nga zoti Kryeministër, i cili kryen detyrën e ministrit të Jashtëm, për disa probleme që kanë dalë për sa i përket dikasterit të Ministrisë së Jashtme.

Problemi i parë mendoj se është çështja e delegimit të kompetencave, sepse jemi informuar, të paktën nga mediet, që ministri në detyrë ka një sërë kompetencash dhe sekretari i Përgjithshëm ka kompetenca të tjera. Duam të dimë cili është roli i ministrit në këto momente? Kush e luan rolin e ministrit? Ndoshta do të ishte mirë që Kryeministri të informojë Komisionin e Jashtëm për këtë gjë.

Së dyti, gjykoj se për problemet që kanë dalë në Ministrinë e Jashtme, si pasaportat diplomatike, targat apo probleme të tjera, është mirë që ne si komision të kemi një informim, çfarë problemesh ka pasur konkretisht, të cilës natyre janë këto probleme, kur janë shkaktuar dhe çfarë pasojash kanë krijuar?

Së treti, siç e dimë, dje konkretisht ndodhi një ngjarje në parlamentin Holandez, i cili votoi për kthimin e vizave për Shqipërinë. Ne si komision duhet të njohemi nga Ministria e Jashtme për problemet që e kanë çuar këtë parlament në marrjen e këtij vendimi dhe duhet të dimë çfarë masash duhet të marrë më tej qeveria, me qëllim që në prag të hapjes së negociatave është e mira të koordinohen të gjithë faktorët dhe aktorët, që të minimizohet efekti i tyre, por edhe opinioni publik duhet të sqarohet për qëndrime të tilla.

Së fundi, ndoshta problemet e integritetit mund t'i trajtojë Komisioni i Integritetit, por meqenëse ndodhemi para hapjes së negociatave, gjykoj se është e nevojshme të informohemi në cilin stad ndodhemi, cilat janë detyrat që duhet të kryejmë edhe ne si komision, por edhe si deputetë, me qëllim që fundi i qershorit të na gjejë me negociata të çelura.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Karamelo!

E vlerësoj dhe e gjykoj interesante kërkesën tuaj!

Është në të drejtën tuaj si anëtar i këtij komisioni dhe patjetër në detyrimin tonë si anëtarë të parlamentit të Kuvendit të Shqipërisë të thërrasim në seancë dëgjimore ministrin në detyrë të Punëve të Jashtme dhe Europës. Besoj se këtë mund ta bëni lirisht duke ndjekur një procedurë të thjeshtë parlamentare dhe të caktojme një datë, sigurisht konveniente për axhendën e ministrit në detyrë dhe për axhendën e komisionit tonë, në mënyrë që të marrim përgjigjet, të cilat, ju i parashtruat me të drejtë,.

Në vazhdim mund të procedojmë me këtë gjë, përtej miratimit të punës sonë për tri javët e ardhshme. Besoj se është diçka që mund ta realizojmë pa më të voglin dyshim dhe pa problem.

Nëse nuk ka gjë tjetër për procedurë, zonja Voda, fjala është për ju, shkurtimisht, në mënyrë shteruese, mund të na flisni për çfarë bën fjalë projektligji.

Faleminderit!

Rovena Voda – Faleminderit, zonja kryetare!

Projektligji që kemi sot për diskutim dhe miratim para komisionit tuaj ka të bëjë me marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta të kontrollit kufitar.

Në fakt, është iniciativë, dëshirë dhe vullnet i të dyja qeverive të vendeve tona për ta miratuar këtë marrëveshje, e cila, sigurisht, ka si qëllim kryesor kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve dhe mjeteve në pikat e kalimit kufitar midis Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës.

Aktualisht, më lejoni t'ju bëj me dije se aplikimi i kësaj marrëveshjeje është një formë që lejohet edhe para ratifikimit në Kuvendin e Shqipërisë. Praktikisht ka filluar në pikën kufitare të Morinës, e cila është pika më e madhe e kalimit kufitar që kemi ne me qeverinë e Kosovës, ku, në fakt, unë do të jap disa shifra. Vetëm gjatë viteve të fundit fluksi i hyrjeve dhe daljeve, kryesisht në sezonin veror, ka qenë gjithnjë e në rritje. Vjet, për shembull, në periudhën janar-shtator 2018, në pikën kufitare të Morinës kanë kaluar gjithsej 4 milionë e 794 mijë e 138 shtetas me 1 milionë e 470 mijë e 524 mjete, hark kohor i cili ka brenda edhe fluksin e sezonit turistik veror. Besoj se është një benefit i përbashkët i qytetarëve të dy shteteve tona, Shqipërisë dhe Kosovës, dhe mendoj se jemi në kohë, ose ndoshta pak të vonuar, për miratimin e kësaj marrëveshjeje, e cila, nga Morina, ndoshta mund të aplikohet edhe në pika të tjera kufitare, që përgjithësisht janë të vogla, me Kosovën. Aplikimi i kësaj marrëveshjeje vjen edhe pas një investimi që Komisioni Europian ka bërë në pikën kufitare të Morinës, investim i ndjekur nga delegacioni i BE-së këtu në Tiranë, duke i paraprirë edhe idesë së kësaj pike të përbashkët.

Zonja kryetare dhe të nderuar deputetë, ne sot kemi një godinë të re të ndërtuar me këto fonde, e cila është konceptuar si një godinë e përbashkët e të gjitha autoriteteve policore dhe doganore të të dyja vendeve, me qëllim për të rritur edhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet njësive që operojnë në pikën kufitare të Morinës.

Gjithashtu, është në mbarim e sipër, isha edhe unë vet në inspektim para një jave në pikën kufitare të Morinës, godina që dikur ka qenë Komisariati i vjetër i Policisë, ku po bëhen mjedise shumë moderne, me standarde të larta, për të ndaluar, apo dhoma për viktima të

mundshme të trafikimit ose për intervistimin nëse do të identifikohen emigrantë të paligjshëm. Kjo besoj se do të jetë një aset në punën e përditshme kufitare atje.

Po ashtu, numri i korsive dhe i kabinave është rritur. Ka qenë një pikë kufitare vetëm me 6 korsi dhe sot është me 12 të tilla. Normalisht, sot operojmë me 6 korsi ne dhe me 6 korsi Kosova.

Siç e thashë, ka filluar në praktikë implementimi nëpërmjet edhe një marrëveshjeje të përbashkët të të dyja policive kufitare dhe të migracionit aty. Pra, ideja është për të pasur një *one stop shop* ose një ndalesë-një kontroll. Nuk do të kemi më kontrolle hyrjeje dhe daljeje. Qytetarët që shkojnë për në Kosovë do të bëjë një kontroll nga pala kosovare dhe ata që do të vijnë drejt Shqipërisë do të kenë një kontroll nga Policia Kufitare e Shqipërisë.

Sigurisht, e kuptojmë se benefitet e kësaj marrëveshjeje janë shumë të mëdha. Do të thosha se ka një eksperiencë të mirë të Ministrisë së Brendshme, por edhe të Policisë Kufitare në aplikimin e modelit të pikave të përbashkëta të kalimit kufitar. Këtu mund të përmend Murriqanin, që është pikë e përbashkët e kalimit kufitar që ne kemi me Malin e Zi, e cila shkurton ndjeshëm lëvizjen e njerëzve dhe automjeteve të vogla. Hani i Hotit përdoret më shumë për qarkullimin e mallrave nëpërmjet kamionëve e të tjera. E thashë edhe një herë, është një vlerë e shtuar dhe unë e ftoj komisionin ta votojë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Ka pyetje apo diskutime? Nuk ka.

Unë ju ftoj që këtë eksperiencë pozitive në shërbimin dhe në ndihmë të qytetarëve në të dyja anët e kufirit të mund ta transmetoni edhe në pikat e tjera kufitare që nuk janë ato me Kosovën apo me Malin e Zi, pasi do të ishte absolutisht jo e pamundur, por një suport i madh për qytetarët që jetojnë në shtetin fqinj të Greqisë apo për shqiptarët që duan të kalojnë pushimet atje me qëllim që të mund të evitojmë edhe radhët e pafundme, sidomos në periudhën e festave apo në periudhën e verës. E di që jeni duke bërë përpjekje, dua thjesht dhe vetëm që ta risjell në vëmendje këtë gjë. Shpresoj shumë se do të jemi këtu ku do të sillni një projektligj, i cili do të mundësojë një pikë unike kufiri midis nesh dhe shtetit fqinj grek apo maqedonas, pse jo.

Urdhëroni, nëse ka nevojë për ndonjë sqarim!

Rovena Voda - Faleminderit zonja kryetare për risjelljen në vëmendje!

Kjo tregon edhe një mbështetje të këtij komisioni për të gjithë punën që po bën Ministria e Brendshme. Siç e thatë edhe ju, jeni në dijeni, ne aktualisht jemi në bisedime edhe

me palën maqedonase, me Maqedoninë e Veriut tashmë, por edhe me Malin e Zi për ta shtritur këtë model edhe me këto dy vende, ku kemi një qarkullim shumë të madh.

Ndërsa me Greqinë doja të theksoja vetëm diçka: dëshira është shumë e madhe, ndoshta për të hapur një pikë të përbashkët kalimi kufitar me Greqinë. Po përpiqemi në dy drejtime. Pika e përbashkët mund të jetë pak e vështirë, sepse ata janë një vend i zonës Shengen dhe kanë një lloj sistemi tjetër, sistemin SIS, i cili nuk mund të ndahet me ne, për shkak se për BE-në ne jemi një vend i tretë. Pra, kjo nuk mundet, por jemi në negociim e sipër dhe ndoshta në përfundim të idesë së krijimit të një qendre të përbashkët në Kakavijë, të bashkëpunimit policor dhe doganor, një model shumë i mirë, me një vend si Shqipëria, me një vend fqinj që është anëtar i BE-së. Besoj se kjo mund të finalizohet.

Mimi Kodheli- Faleminderit!

Nëse nuk ka diskutime, kalojmë në votim. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Falënderoj zonjën zëvendësministre për prezencën !

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Procesverbal

Tiranë, më 17.04.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1.Seancë dëgjimore për emërimin në postin e kreut e misionit diplomatik të zotit Gazmend Barbullushi, kandidat për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Marokut, në Republikën Islamike të Mauritanisë si dhe Principatën e Andorës.

Marrin pjesë: Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Ervin Bushati, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermani, Evis Kushi, Andrea Marto, Reme Lala, Ligoraq Karamelo, Edlira Hyseni

Mungojnë: Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Rudina Hajdari

Të ftuar:

Sokol Dedja – Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gazmend Barbullushi – kandidat për kreun e misionit diplomatik, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Mimi Kodheli - Të ftuar në seancën dëgjimore kemi zotin Dedja, zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Mirë se vini!

Zotin Barbullushi, kandidat për kreun e misionit diplomatik në Mbretërinë e Spanjës, ende në detyrë sekretar i Përgjithshëm i ministrisë.

Zotërinj, fjala është për ju.

Sokol Dedja - Falemiderit, zonja kryetare!

Kam kënaqësinë të paraqes zotin Barbullushi si kandidat për këtë post të rëndësishëm. Zoti Barbullushi është diplomat karriere që nga viti 1992, mban aktualisht gradën ministër fuqiplotë, sekretar i Përgjithshëm i ministrisë sonë që nga viti 2016. Përveç detyrave të tjera të larta që ka mbuluar në ministrinë tonë si drejtor i Përgjithshëm, drejtor drejtorie, ai ka mbuluar më parë postin e ambasadorit në Mbretërinë e Vendeve të Ulëta në vitet 2009-2014, si dhe ka qenë i ngarkuar me punë në vendet partnere shumë të rëndësishme si: Gjermania dhe Sllovenia.

Më lejoni të shpreh besimin se mbulimi i këtij posti nga zoti Barbullushi do të energjizojë më tej marrëdhëniet tona me Spanjën, si për sa i përket thellimit të marrëdhënieve dypalëshe ku një fokus të veçantë duhet të ketë diplomacia ekonomike, pasi këtu ka vend për më tepër thellim të marrëdhënieve tona me Spanjën, po ashtu edhe për sa i përket procesit të integritetit evropian Spanja është një vend anëtar i BE-së që është pozitive, por nuk mund të merret e mirëqenë, do të vazhdojmë punën informuese nëpërmjet ambasadorit, dialogun e vazhdueshëm edhe me autoritetet spanjolle.

Mbetet e vazhdueshme kërkesa jonë për Spanjën, nënvizimi i rëndësisë që do të kishte për ne njohja e sovranitetit të Kosovës.

Besojmë se zoti Barbullushi është kandidati i duhur për të arritur këto objektiva.

Faleminderit!

Gazmend Barbullushi – E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Kam privilegjin e veçantë të paraqitem para komisionit si kandidat për ambasador në Mbretërinë e Spanjës, rezident, në Mbretërinë e Marokut, në Principatën e Andorrës dhe në Republikën Islamike të Mauritanisë si jorezident.

Më poshtë do të përpiqem t'ju njoh shkurtimisht sa u takon marrëdhënieve me këto vende, si dhe objektivat e punës time, nëse do të kem besimin tuaj.

Sa i takon Spanjës, marrëdhëniet me këtë vend janë të mira edhe pa çështje bilaterale të hapura, por dëshira jonë është për të pasur një dialog politik më intensiv.

Bilanci i deritanishëm i vizitave zyrtare të niveleve të larta, i cili merret si indikator vlerësues, mbetet i ulët. Mund të përmend dy vizita zyrtare në nivel ministri: në 2009-ën ministri Moratinos ka vizituar Tiranën. Më pas, në vitin 2015, zoti Bushati ka reciprokuar. Megjithatë, nuk kanë munguar takime të tjera të niveleve të larta, në marzhet e takimeve ndërkombëtare.

Dy fjalë për situatën e brendshme të Spanjës. Për momentin Spanja gjendet në fushatë elektorale. Zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme mbahen më datë 28 të këtij muaji. Si favorite konsiderohen dy parti tradicionale: socialistët e PSOE-së, e kryesuar nga Kryeministri aktual Pedro Sançez, dhe Partia Popullore Konservatore, që është në opozitë, e udhëhequr nga Pablo Casado. Është e pritshme që qeveria e ardhshme, pavarësisht fituesit, të jetë qeveri koalicioni, bashkë me partitë e tjera më të vogla.

Programet ekonomike të partive janë në qendër të fushatës elektorale. Me sa duket, do të fitojë ajo parti që do t'i bindë votuesit se do t'i mbajë ritmet e rritjes ekonomike, që janë shënuar në vend vitet e fundit.

Po ashtu, kartë shumë e rëndësishme elektorale është trajtimi i zonave të thella apo në brendësi të vendit, të cilat kërkojnë më shumë vëmendje. Vihet re se ka një ndjeshmëri të lartë politike trajtimi i referendumit për shkëputjen e rajonit të Katalonjës, së bashku me pasojat e tij, si dhe bashkëpunimi me partitë në këtë rajon. Në fakt, ishin deputetët e Katalonjës ata të cilët bënë që qeveria e zotit Sançez të bjerë së fundmi.

Duhet thënë se vitet e fundit, interesi i Spanjës për rajonin e Ballkanit Perëndimor, jo vetëm kundrejt Shqipërisë, ka qenë i kursyer.

Kohët e fundit u fol për një tur rajonal të ministrit të Jashtëm, Borel, tur ku do të përfshihej edhe Tirana, i cili do të shihej si një pikë pozitive infleksioni. Ky tur nuk arriti të mbahej për shkak të kalimit të vendit në fushatë elektorale.

Fokusi i Spanjës, siç pranohet dhe nga vetë përfaqësuesit e saj, janë vendet e Amerikës Latine, Qendrore e të Jugut, apo të së ashtuquajturës zonë e Magrebit, vendet e Afrikës Veriore.

Në interesin tonë më të mirë, është të shohim e të tërheqim vëmendjen e Spanjës drejt rajonit tonë. Ky është dhe do të jetë objektivi kryesor i punës sime, pra përpjekjet për të nxitur he krijuar një dinamikë të dëshiruar në marrëdhëniet me këtë vend.

Duke kaluar te integrimi, Spanja është një vend influent dhe me peshë brenda Bashkimit European. Edhe në këto kohëra të vështira për vetë unionin ka qenë dhe mbetet mbështetëse e integritetit european të Shqipërisë, por edhe të rajonit.

Gjithsesi, detyrë e rëndësishme për ambasadorin mbetet informimi i vazhdueshëm e në detaje i ecursisë së zbatimit të reformave në vend, dhe kryefjalës, që është reforma në drejtësi, përmbushja e pesë prioritetëve kyçe, me theks të veçantë në luftën kundër krimit e korrupsionit.

Kalojmë te një çështje e rëndësishme, që është Kosova. Njihet qëndrimi strikt i Spanjës për të mos e njohur Kosovën. Është e lidhur që në fillim me dekurajimin e ndryshimit të njëanshëm të kufijve. Kosova vijon të shihet si një precedent frymëzues për rajonet me tendenca separatiste, në rastin konkret të Katalonjës, por edhe të rajonit të Baskëve.

Fatkeqësisht, Spanja ka votuar vazhdimisht kundër anëtarësimit të Kosovës në organizmat ndërkombëtare, por hera-herës ka shprehur rezerva edhe ndaj prezencës së saj në formatet e Ballkanit Perëndimor 6.

Në politikën e brendshme nuk vërehet ndonjë ndryshim mes qëndrimeve të forcave kryesore në vend për sa i përket Kosovës.

Për mua do të jetë detyrë parësore vijimi i lobimit, shkëmbimit të argumenteve dhe i informacioneve tona në çdo nivel të shtetit e shoqërisë civile, për ta bërë të qartë rëndësinë që ka Kosova si faktor stabiliteti në rajon, por edhe në kontinent.

Dëshirojmë që Spanja, në pamundësi të njohjes, të mos e pengojë Kosovën në anëtarësimin e saj në organizmat ndërkombëtare, procesin e integritetit dhe nismat rajonale.

Kalojmë te bashkëpunimi dypalësh. Kemi një bashkëpunim shumëpalësh në organizmat ndërkombëtare, që është i vazhdueshëm e shumë pozitiv. Kemi mbështetur reciprokisht qëndrimet e njëri-tjetrit. Kemi marrë mbështetjen e Spanjës për vendin jo të përherëshëm në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën 2022-2023. Spanja na ka mbështetur aktivisht për të marrë kryesimin e OSBE-së për vitin 2020.

Objektiv i punës sime do të jetë vijimi i kësaj politike bashkëpunimi dhe mbështetjes reciproke.

Në Madrid kanë selinë dy organizma të rëndësishëm ndërkombëtarë, si: Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit dhe Organizata Botërore e Turizmit.

Për të parë nëse është e nevojshme të intensifikohen marrëdhëniet, të cilat deri tani kanë qenë statike dhe relativisht të fjetura, duhet të iniciohet menjëherë një vizitë e dedikuar e ministrit përgjegjës për Bujqësinë atje.

Për sa i takon Organizatës Botërore të Turizmit, Ministria jonë për Turizmin ka synime konkrete për të ardhmen, madje po bëhen përpjekje që Tirana të jetë mikpritëse në

vitin 2020 e asamblesë vjetore të organizatës. Po ashtu, është e nevojshme një vizitë e ministrit për Turizmin.

Për të kaluar në një formë tjetër tejet të rëndësishme të bashkëpunimit është ai parlamentar. Situata e brishtë politike parazgjedhore dhe kalimi i vendit në zgjedhje të parakohshme kanë qenë pengesë për realizimin e vizitave në senat dhe në kongres, si dhe për shkëmbimet e tjera ndërparlamentare. Kontakti me parlamentin e ri duhet të riaktivizohet menjëherë për të realizuar kështu veprimtari dhe vizita të ndërsjella, veçanërisht të komisioneve përgjegjëse për politikën e jashtme dhe integrimin europian.

Për sa i takon dimensionit ekonomik, bashkëpunimi ekonomik mbetet i reduktuar, megjithëse ka njohur rritje. Në Shqipëri janë vendosur ose kanë projekte bashkëpunimi kompani të rëndësishme spanjolle, si: Ineco, Intra, Raxol, Enagas e të tjerë.

Dy gjigantët spanjollë turistikë “Meliá” dhe “Iberostar” kanë hartuar dhe po zbatojnë projekte konkrete, të cilat, në fakt, kanë gjeneruar sinjale tejet pozitive për investitorët e tjerë potencialë spanjollë. Vihet re, gjithashtu, se rrjeti i agjencive tona turistike po hyn gradualisht në tregun spanjoll. Në vitin 2017 janë shënuar 1800 turistë spanjollë, ndërsa në vitin 2018 kanë qenë 5000 të tillë. Është e vogël si shifër, por inkurajuese. Sektorët për të cilët janë interesuar kompanitë spanjolle janë: infrastruktura, turizmi, hidrokarburet, mineralet, bujqësia apo edhe projektet energjetike.

Për sa u përket shifrave për të njohur volumin e shkëmbimeve tregtare, në vitin 2017 volumi i shkëmbimeve ka qenë 213 milionë euro, importet kanë qenë në nivelin 101 milionë euro, eksportet kanë qenë në nivelin 112 milionë euro, pra shënojmë një bilanc pozitiv. Ky trend pozitiv ruhet edhe për vitin 2018 dhe fillimin e vitit 2019. Sipas regjistrimit tregtar, në Shqipëri operojnë 33 biznese spanjolle, kryesisht në tregti, turizëm, prodhime bujqësore dhe ndërtim.

Si përfundim, Shqipëria ende nuk njihet sa duhet për sipërmarrjen spanjolle. Pra, mund të themi se ka mjaft për të bërë në promovimin e Shqipërisë, tërheqjen e investimeve, por edhe hyrjen në tregun spanjoll me produktet tona. Natyrisht, diplomacia ekonomike do të mbetet objekt primar i punës sime, me promovimin e vendeve, lidhjen e kontakteve me biznesin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Shkurtimisht, për sa i përket kulturës, vihet re një interes në rritje në shoqërinë shqiptare për të njohur kulturën dhe gjuhën spanjolle. Ne e kemi inkurajuar vazhdimisht palën spanjolle për hapjen në Shqipëri të Institutit “Servantes” dhe të Shtëpisë së Spanjës. Vetë Spanja dallohet për diplomacinë e saj kulturore jashtë vendit. Toleranca fetare dhe

multikulturalizmi në Shqipëri vlerësohen në opinionin e gjerë spanjoll dhe duhet të promovohen më tej.

Për të kaluar te diaspora dhe emigracioni, emigrantët shqiptarë me leje qëndrimi në Spanjë janë saktësisht 2318 individë, nga të cilët është një grup të vogël studentësh, saktësisht 26, por komuniteti shqiptar në këtë vend shkon rreth 8000 persona. Është një komunitet i mirintegruar, por pak i organizuar në disa shoqata të vogla. Me emigracionin tonë atje nuk kemi probleme të veçanta, megjithatë është i nevojshëm shtimi i vëmendjes dhe përmirësimi i mëtejshëm i shërbimeve.

Prej nesh, së fundi, është kërkuar nënshkrimi i marrëveshjeve për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit dhe njohjen e sigurimeve shoqërore, të cilat janë në proces. E vlerësoj mjaft të rëndësishëm bashkëpunimin e ngushtë me diasporën për promovimin e vlerave tona kombëtare dhe kulturore në Spanjë.

Për sa i takon kuadrit ligjor, kemi një kuadër ligjor relativisht të plotë të marrëveshjeve dhe akteve të përbashkëta. Disa prej tyre janë në proces, ndër të cilat përmenda lejet e drejtimit dhe siguracionet shoqërore.

Po kaloj te Mbretëria e Marokut, me të cilën kemi marrëdhënie të mira dhe vullnet për t'i intensifikuar më tej. Maroku na ka dhënë mbështetjen e tij për vendin jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit për periudhën 2022-2023.

Edhe ky vend nuk e ka njohur ende Kosovën, edhe pse kemi kërkuar vazhdimisht prej tij ta ndërmarrë këtë hap dhe të mos bëhet të paktën pengesë për pranimin e Kosovës në organizatën ndërkombëtare.

Biznesi maroken është ftuar të vijë dhe të punojë në Shqipëri, është i nevojshëm shtimi i kontakteve midis subjekteve të të dyja vendeve dhe promovimi i mundësive që ofron Shqipëria. Natyrisht, ka një numër shumë të vogël biznesesh të përbashkëta, janë vetëm 5 të regjistruara. Fushat më me interes janë: infrastruktura, tregtia, turizmi dhe produktet bujqësore. Kuadri ligjor është i paktë dhe disa propozime janë në proces.

Si përfundim, ambasadorit i duhet të bëjë punë të veçantë për Marokun, në mënyrë që të nxisë sa më shumë për mosbllokimin e Kosovës në organizma ndërkombëtare, me synim njohjen e saj. Duhet të nxiten kontaktet në nivele të larta dhe të intensifikohen më tej. Shkëmbimet ndërparlamentare, ashtu siç kanë bërë deri tani, ku ka pasur dy vizita të nivelit të lartë, të Kryetarit të Kuvendit, që ka dhënë impulse vazhdimisht, luajnë një rol inkurajues dhe nxitës.

Me interes për ne janë shkëmbimet ekonomike dhe të biznesit. Me Andorën kemi bashkëpunim të mirë, por të rrallë, ku kemi disa marrëveshje të nënshkruara. Andora e ka

njohur Kosovën dhe ka dhënë mbështetjen e saj për marrjen e kryesimit të OSBE-së nga Shqipëria. Po punohet për arritjen e një marrëveshjeje për mbështetjen e kandidaturës sonë për vendin jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit. Me këtë vend është e nevojshme mbajtja dhe intensifikimi i kontakteve të drejtpërdrejta. Aty ka filluar puna dhe po punohet për të shkëmbyer vizita reciproke të nivelit të lartë.

Për sa i takon Mauritanisë, duhet pranuar që kemi kontakte të rralla, të cilat duhet të shtohen dhe duhet të mirëmbahen rregullisht. Jemi takuar me këtë vend në forumet ndërkombëtare, si: OKB-ja dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Për fat të mirë kemi arritur tashmë një marrëveshje me këtë vend për mbështetje për vendin jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit, por që nuk kemi ende një akt të përbashkët të firmosur.

E nderuar zonja kryetare, të nderuar deputetë,

Ky ishte një prezantim i shkurtër i marrëdhënieve me Spanjën dhe vendet e tjera, të cilat mbulohen nga ambasadori në Madrid, si dhe objektivave të punës sime, nëse do të kem besimin tuaj. Do të bëj të gjitha përpjekjet e mia maksimale për të realizuar me sukses misionin e lartë të ambasadorit, prezantimin dinjitoz të vendit dhe arritjen e objektivave që prezantova. Paraardhësit e mi kanë bërë një punë mjaft të mirë dhe gjej rastin t'i falënderoj për angazhimin dhe rezultatet që kanë arritur.

Veç besimit, kërkoj edhe mbështetjen tuaj si anëtarë të këtij komisioni të nderuar. Jam i bindur se diplomacia parlamentare është një nga instrumentet më efikase në thellimin e bashkëpunimit me vendet e tjera, në veçanti me vendet që do të mbuloj. Jam në dispozicionin tuaj për pyetje apo për diskutime.

Mimi Kodheli- Ju falënderoj, zoti Barbullushi, për prezantimin serioz dhe dinjitoz që bëni. A ka pyetje apo diskutime nga kolegët? Po, zoti Bushati, fjala për ju.

Ditmir Bushati- Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, dua të shpreh kënaqësinë për këtë kandidaturë, për zotin Barbullushi, me të cilin unë kam pasur fatin dhe mundësinë për të punuar në disa pozicione, qoftë në pozicionin e drejtuesit të një misioni diplomatik të rëndësishëm në Holandë, një vend me të cilin ne kemi pasur dhe kemi raporte shumë të mira, por për shkak edhe të pozicionit të njohur të Holandës për sa u përket çështjeve të zgjerimit, na është dashur gjithmonë të kemi një fokus më të ri dhe një punë më kapilar; gjithashtu, edhe në pozicionin e rëndësishëm të Drejtorit të Çështjeve Konsullore dhe më pas të Sekretarit të Përgjithshëm apo nëpunësit më të lartë civil të shërbimit të jashtëm. Në këtë kuptim, them që është nder për Shqipërinë për t'u përfaqësuar në Spanjë me këtë nivel, por nuk do ta ekzagjeroja po të thosha që është nder

edhe për Spanjën, sepse kemi një traditë pozitive të përfaqësimit në nivel diplomatik të lartë, sipas standardeve tona.

Së dyti, meqenëse nuk kemi kujtuar shumë nga politika e ditës, them që është momenti për ta falënderuar zotin Barbullushi edhe për rritjen e pagave të shërbimit, meqenëse më 1 prill pagat e shërbimit rriten mbi 20 %, përgjithësisht lajm bëjnë çështjet e tjera dhe jo çështjet konkrete për fuqizimit e shërbimit, aq më tepër kur flasim për një numër relativisht të vogël të ambasadave dhe një shërbim të vogël që ne kemi. Siç u pa në prezantim, është e qartë që me kapacitetet që ne kemi në një pjesë të mirë të vendeve për të mbuluar tri vendet e tjera, është një sfidë më vete, duke shtuar këtu edhe faktin që një pjesë e këtyre vendeve kanë një qasje të ndryshme nga vendi bazë ku stacionohet ambasadori, që është Spanja.

Së treti, mendoj se me Spanjën duhet të fokusohemi te çështjet e diplomacisë ekonomike, duke qenë se është edhe një prioritet i qeverisë, edhe në vazhden e gjithë interesit të biznesit spanjoll në Shqipëri, partneriteteve që kanë ndërtuar me kompani serioze shqiptare, kontakteve që janë zhvilluar në nivele më të larta, ndoshta është momenti që të lehtësohen më tej dhe të materializohen.

Së katërti, zonja kryetare, unë e kam kërkuar edhe kur kam qenë ministër që këto seanca është mirë të bëhen me dyer të mbyllura, në qoftë se duam një diskutim dhe debat sa më të thellë dhe serioz.

Ambasadori përmendi faktin se ne kemi shkëmbyer mbështetje reciproke për disa nga objektivat kryesorë të politikës sonë të jashtme, një prej të cileve edhe fitimi i një vendi jo të përhershëm në këshillin e sigurimit. Këto janë përgjithësisht tema apo çështje, të cilat nuk i bëhen të njohura publikut, edhe për shkak të faktit se të njëjtin objektiv mund ta bashkëndajnë edhe vende të tjera, sikundër pozicionimin e Spanjës në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë më të posaçme me Kosovën apo Shqipërinë dhe faktorin shqiptar në përgjithësi. Jam i sigurt se në rast se ne do të kishim një ambient më të relaksuar do të kishim ndoshta edhe një diskutim më të thellë dhe më të detajuar me njëri-tjetrin, ndoshta do të kishim mundësi për të pasur disa ide apo disa sugjerime konkrete.

Së fundi, përtej diplomacisë ekonomike, është diplomacia kulturore. Në vitet e shkuara ka pasur një përpjekje serioze të ambasadës spanjolle në Tiranë dhe të fondit spanjoll për bashkëpunimin ndërkombëtar. Kujtoj këtu që personalitete të medias, të shoqërisë civile, të parlamentit spanjoll kanë vizituar Shqipërinë. Kemi bërë seanca *brainstorming* për çështje delikate për publikun spanjoll. Është e domosdoshme që një praktikë e tillë, qoftë edhe në bashkëpunim me ambasadën spanjolle këtu të riaktivizohet, sepse kjo do ta ndihmonte shumë

edhe formësimin e një politike disi më ndryshe të Spanjës në raport me disa çështje, të cilat janë të rëndësishme për ne dhe konsiderohen si çështje të përparësisë kombëtare.

Praktika me Institutin Servantes do të ishte më se e mirëpritur, aq më tepër që ka edhe precedentë me Institutin Italian të Kulturës, me Institutin Gëte, me Kinën, me të cilën operohet në nivelin e edukimit dhe të kulturës. Në këtë kontekst do të ishte mirë që ne ta mbështesnim fort këtë prioritet, sepse do të ishte një ndihmë e madhe edhe në funksion të objektivave politikë që ne kemi në raport me Spanjën.

Ju e thatë edhe në prezantimin tuaj, që për shkak të historisë dhe për shkak të pranisë si e ftuar e përhershme në G20, Spanja është pikë referimi për Amerikën Latine, ku praktikisht ne nuk është se kemi një qasje të esëllt në funksion të arritjes së disa objektivave, qoftë në kuadrin e OKB-së, qoftë në kuadër të diplomacisë ekonomike. Pra, edhe në këtë drejtim mund të përdoret si një mundësi e mirë për të hapur dyer të tjera, që momentalisht janë të mbyllura për ne.

Shumë suksese dhe komplimentet e mia zonja kryetare, sepse në një kohë rekord keni bashkëpunuar qoftë me institucionet përgjegjëse, qoftë me zyrën e Kryeministrit dhe qoftë me zyrën e Presidentit për ta sjellë këtë seancë dëgjimore në një kohë rekord!

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bushati!

Jam dakord me ato që thatë. Mendoj se është në të drejtën tonë që të propozojmë ndryshime të rregullores së këtij komisioni kur flitet për gjëra të një sensibiliteti dhe të një konfidencialiteti të caktuar. Sigurisht, kjo jo për mosinformim apo mostransparencë të publikut, por për arsyet që ju i përmendët dhe i nënvizuat. Kështu që është një gjë që mund ta diskutojmë në vazhdim. Nuk kam çfarë t'u shtoj komenteve të zotit Bushati, përveç faktit që dua të rinëvizoj ambasadorin Barbullushi, që Spanja, duke qenë një vend me një dominancë të caktuar gjeopolitikë, kur flitet për Amerikën Latine dhe për aq kohë sa ne nuk kemi përfaqësi të mirëfilltë këtë kontinent e mbulojmë në distancë pikërisht nga ky vend. Kështu që vetë ju, përtej angazhimit tuaj si rezident në Mbretërinë e Spanjës në një të ardhme të afërt shpresoj, po ashtu jo rezident në vendet që ju përmendët, të mund të keni një fokus më të madh që lidhet me një pjesë të rëndësishme të botës, siç është bota latine dhe Amerika Latine në mënyrë të veçantë.

Ligoraq Karamelo -Faleminderit!

Unë shpreh mbështetjen time për kandidaturën e zotit Barbullushi. E njoh prej shumë vitesh që kur ka qenë në zyrën konsullore dhe e di që është një diplomat karriere. Nuk dua të shtoj fjalët që tha ish- ministri për karakteristikat e tij profesionale dhe aktivitetin.

Unë do të thosha që marrëdhëniet me Spanjën janë një sfidë e veçantë për vendin tonë, qoftë për problemet që u prekën, qoftë edhe për probleme të tjera që qëndrojnë gjithmonë në axhendën e integritetit. Së pari, me sa kam ndjekur, shikoj që marrëdhëniet me Spanjën nuk janë në nivelin e dëshiruar, historikisht dëshira jonë për të pasur marrëdhënie me këtë vend ka qenë shumë e madhe. Me eksperiencën që ju keni dhe ndjekjen e këtij problemi, cilat janë pengesat që hasen në këto marrëdhënie?

Së dyti, personeli i ambasadës sonë në Spanjë i çfarë niveli është? A e përballon dot këtë sfidë? Në çfarë niveli është ambasada jonë atje në krahasim me vendet e tjera të BE-së?

E mbështes kandidaturën e zotit Barbullushi.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Gazmend Barbullushi – Faleminderit!

Së pari, më lejoni të falënderoj zotin Bushati për konsideratat e larta dhe mbështetjen që i dha shërbimit të jashtëm për rritjen e të ardhurave që nga 1 prilli, gjë që është shumë e rëndësishme dhe inkurajuese!

Gjithashtu, jam dakord me të gjitha ato që zoti Bushati tha se diplomacia ekonomike ka momentin më të mirë për t'u livruar, për t'u përkujdesur. Unë listova një sërë firmash serioze dhe të rëndësishme spanjolle që kanë aktivitet në Shqipëri, kështu që do të jetë një nga prioritetet e mia më të para.

Sa u takon pyetjeve të zotit Karamelo, të cilin e falënderoj për konsideratën, Spanja është një vend mjaft influent në vendet e Amerikës Latine, të Afrikës së Veriut, gjithashtu edhe të pellgut të Mesdheut. Kështu që i shoh si një sfidë dhe jam i kënaqur që paraardhësit e mi kanë bërë gati terrenin për të vazhduar më tej. Marrëdhëniet janë shumë të mira, por, siç e thashë, që pranohet edhe nga përfaqësuesit spanjollë, vëmendja e tyre ka qenë tjetërkund, ka qenë shumë më e rrallë dhe më e kursyer për rajonin.

Kjo është sfida ime e dytë për të bërë ç'është e mundur përmes kontakteve për të shfrytëzuar momentin e qeverisë së re, për të nxitur interesin e tyre jo vetëm ndaj Shqipërisë, por edhe ndaj rajonit. Nuk po flas për kapacitetin e rajonit, por duhet të kuptojmë që sa më shumë vëmendje të ketë për rajonin, aq më shumë vëmendje do të kemi edhe për vendin. Kjo do të thotë që nuk ka pengesa, por Spanja ka pasur prioritetet e saj, të cilat kanë qenë të kushtëzuara edhe nga kriza ekonomike disa vjeçare që ka kaluar në eurozonë.

Sa i përket punës së personelit të ambasadës, nëse e përballon dhe çfarë rëndësie ka ambasada jonë në Spanjë, në fakt, ka rëndësinë e duhur. Janë 5 nivele të ambasadave dhe ambasada jonë hyn te niveli i dytë i kategorive dhe konsiderohet një ambasadë mjaft e rëndësishme.

Struktura e saj është 1+2, unë do të doja më shumë, por ekziston edhe çështja e buxhetit, megjithatë jam me fat që dy diplomatë mbështesin aktivitetin e ambasadorit.

Mendoj se për aq sa është e nevojshme, është e përballueshme, por gjithsesi i takon zotit Dedja që të shtojë më shumë personel për këtë ambasadë.

Shpresoj të kem qenë i qartë për sa u shpreha.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Kolegia Gjebrea, fjala për ju.

Elona Gjebrea - Faleminderit, zonja kryetare!

E mbështes kandidaturën e zotit Barbullushi, i cili mendoj se është plotësisht i denjë për këtë post. Duke pasur parasysh edhe eksperiencën time personale në vite, kur kam qenë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, do të thosha se ai është një diplomat shumë korrekt dhe ka përmbushur me përkushtim të gjitha detyrat si rezultat i MKR-së (Mekanizmi Kombëtar i Referimit).

I uroj suksese në punën e tij si ambasador i Spanjës dhe jam e bindur që do të ketë rezultate të mëtijshme për thellimin e bashkëpunimit në shumë fusha ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës!

Faleminderit!

Eglantina Gjermani - Faleminderit!

Edhe unë u bashkohem kolegëve me vlerësimet maksimale. Përgëzime edhe për prezantimin e punës suaj!

Më bëri përshtypje gjatë prezantimit tuaj në mënyrë të veçantë se, përveç pikave të politikave të jashtme apo edhe të integritit, përmendët edhe organizmat ndërkombëtarë që janë në Madrid me të cilat Shqipëria bashkëpunon dhe mund të thellohet më tej, në mënyrë të veçantë me Organizatën Botërore të Turizmit duke qenë se e ka mbuluar atë fushë dhe kemi pasur marrëveshje bashkëpunimi më parë. Gjithmonë prej tyre ka pasur një predispozitë për ta ndihmuar Shqipërinë në spektrin e turizmit në mënyrë konkrete për të promovuar Shqipërinë dhe për të rritur kapacitetet e institucioneve tona në fushën e turizmit.

Nga ana tjetër, duke qenë se vetë Spanja është një vend turistik, jo gjithmonë do të ketë shumë turistë spanjollë, që do të vijnë në Shqipëri, por sugjeroj që për pjesën e turizmit të mund të tërheqim investitorë spanjollë, prej të cilëve të mund të mësojmë standardet që ka Spanja për turizmin duke rritur kapacitetet e institucioneve tona, por edhe atyre private dhe të marrin përvojën e saj që është shumë e rrahur nga turistët.

Faleminderit dhe suksese!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Ministre!

Nëse nuk ka ndonjë diskutim tjetër, mendoj që mbledhjen ta mbyllim këtu. Nuk ka nevojë për votim, thjesht raporti çka u prezantua dhe çka u tha, i kalon Presidentit, i cili do të përkujdeset për akreditimin e ambasadorit, të cilin e falënderoj me gjithë zemër!

Faleminderit kolegë, për prezencën dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA